



KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 712/3 Prot.

Tiranë, më 25.052017

VENDIM QARKULLUES Nr. 106/1, datë 25.05.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë pasi shqyrtoi kërkesën e Ministrisë së Kulturës për shqyrtim e vendimmarrje për projektin "*Rehabilitimi dhe ndërtimi i Pikave të Shërbimit në qytetin antik të Butrintit*", Sarandë, hartuar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës.

VENDOSI:

1. Të miratojë projektin "*Rehabilitimi dhe ndërtimi i Pikave të Shërbimit në qytetin antik të Butrintit*", Sarandë, hartuar nga Instituti i Monumenteve të Kulturës, me kushtin e mosprekjes së nëntokës.
2. Punimet e zbatimit të projektit të realizohen nën mbikëqyrjen e specialistit arkeolog të Parkut të Butrintit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO FURXHI
MINISTER



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO